



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PEJËS / MUNICIPALITY OF PEJA / OPŠTINA PEĆ



KUVENDI I KOMUNËS PEJË

Protokolli: 01-016/01-789

Pejë, datë: 06.01.2025

**Rraporti i funksionimit të kuvendeve të komunave
për periudhën Janar- Dhjetor 2024**

1. Sa mbledhje ka mbajtur Kuvendi i Komunës gjithsej?

Emri i Komunës	Mbledhje rregullta	Mbl. Jashtëzakonshme	Mbl. urgjente	Mb. solemne
Kuvendi i Komunës së Pejës	-XI-	-II-	---	-II-

2. Gjatë zhvillimit të mbledhjeve a ka pasur raste të lëshimit të mbledhjes apo bojkotim të mbledhjeve nëse po ju lutem të ceket data e mbledhjes dhe arsyeja e lëshimit?

- Jo.

3. Sa vendime ka miratuar kuvendi i komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2024?
Të bashkëngjitur e gjeni listen e vendimeve)

- 83 (tetëdhjet e tre) vendime dhe 1 (një) konkluzion nga Seanca e Jashtëzakonshme e K.K. Pejë, dt. 13.09.2024

4. Sa rregullore ka miratuar kuvendi i komunës për periudhën Janar-Dhjetor 2024

- Asnjë.

5. Sa nga aktet e miratuara nga kuvendi pas vlerësimit të ligjshmërisë nga niveli qendror ju kanë kthyer në rishqyrtim të shkruhen me emër akti, data e kthimit

nga Ministria si dhe data e rishqyrtimit dhe harmonizimit nga komuna si ne tabelën më poshtë:

Nr	Emri i aktit Modeli si duhet te jetë	Emri i Komunës	Data e dërgimit ne Ministri	Data e kthimit te kërkesës për rishqyrtim nga MPL ne komunë	Data e rishqyrtimit dhe harmonizimit nga kuvendi i komunës
1.	Vendimi Nr. 01-2024 mbi ndarjen - rezervimin e postit të ZV-Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës	Komuna Pejë	29.01.2024	Kërkesë për rishqyrtim nga MAPL, Nr.020-81/2, dt. 21.02.2024 (jashtë afatit kohor dhe ligjorë 15 ditorë) ¹	
2.	Vendimi Nr. 03-2024 mbi për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit “Lumbardhë”	Komuna Pejë	28.02.2024	Kërkesë për rishqyrtim nga MAPL, Nr.020-165/1, dt. 12.03.2024	28.05.2024
3.	Vendim Nr. 19-2024 - Plani Lokal i Veprimit në Mjedis Pejë 2024-2028	Komuna Pejë	30.05.2024	Kërkesë për rishqyrtim nga MMPHI, Nr.3611-2/24, dt. 27.06.2024 . (jashtë afatit kohor dhe ligjorë 15 ditorë) ²	

¹ Kërkesë për rishqyrtim nga MAPL për këtë akt në këtë rast është e pasafatshme bazuar në paragrafin 81.4 të nenit 81 Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ku thuhet se “atoriteti mbikëqyrës obligohet që të japë mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar, brenda 15 ditësh nga pranimi i tij, në pajtim me procedurat e përmendura më lartë”.

² Kërkesë për rishqyrtim nga MMPHI për këtë akt në këtë rast është e pasafatshme bazuar në paragrafin 81.4 të nenit 81 Shqyrtimi i detyrueshëm i ligjshmërisë të Ligjit Nr. 03/L – 040 Për Vetëqeverisjen Lokale të Republikës së Kosovës, ku thuhet se “atoriteti mbikëqyrës obligohet që të japë mendimin e tij për ligjshmërinë e çdo akti të regjistruar, brenda 15 ditësh nga pranimi i tij, në pajtim me procedurat e përmendura më lartë”.

6. A janë të publikuara aktet e miratuara në kuvendin e komunës në web faqen e komunës nëse po të ceket numri sa janë publikuar dhe a janë të publikuara në të dy gjuhët?
- Po janë publikuar në dy gjuhët 66 akte dhe 1 (një) konkluzion nga Seanca e Jashtëzakonshme e K.K. Pejë, dt. 13.09.2024. Ndërsa 17 akte tjera të seancës së fundvitit të dt. 30.12.2024 do të publikohen pas afatit të shqyrtimit të ligjshmërisë.
7. Sa mbledhje ka mbajtur Komiteti për Politike dhe Financa për periudhën Janar-Dhjetor 2024?
- 11 (njëmbëdhjetë)
8. Sa mbledhje ka mbajtur Komiteti për Komunitete për periudhën Janar-Dhjetor 2024?
- 11 (njëmbëdhjetë)
9. A ka themeluar kuvendi komunës gjatë këtij viti komitetet konsultative nëse po cilat dhe a kanë mbajtur ndonjë takim?
- Jo. Kuvendi i ka themeluar këto komitete në korrik të vitit 2023. Për shkak të mos pagesës së tyre disa prej këtyre komiteteve nuk po i mbajnë takimet.
10. A ka themeluar ndonjë komitet tjera kuvendi komunës gjatë këtij viti dhe nga sa takime kanë mbajtur?
- Jo. Kuvendi i ka themeluar këto komitete në vitin 2022. Për shkak të mos pagesës së tyre disa prej këtyre komiteteve nuk po i mbajnë takimet.
11. A ka raportuar Kryetari i komunës gjatë kësaj periudhe në kuvendin e komunës nëse po datat e mbledhjes kur ka raportuar dhe për çfarë arsye ka raportuar?
- Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi gjendjen ekonomiko-financiare të Komunës së Pejës, seanca e Kuvendit të Komunës së Pejës, dt. 26.01.2024.

- Shqyrtimi i informatës së kryetarit mbi planin e punës së ekzekutivit për 2024, seanca e Kuvendit të Komunës së Pejës, dt. 26.01.2024.
- Shqyrtimi i informatës mbi raportin vjetor të Komunës së Pejës për vitin 2023, seanca e Kuvendit të Komunës së Pejës, dt. 26.01.2024.
- Shqyrtimi i raportit të punës së Kryetarit të Komunës për gjashtë-mujorin e parë 2024, dt. 26.07.2024.
- Shqyrtimi i informatës për gjendjen ekonomiko-financiare në Komunën e Pejës, dt. 29.10.2024.
- Shqyrtimi i Raportit të Punës së NJAB mbi nivelin e rekomandimeve për 2024, dt. 30.12.2024.

12. Ligji për vetëqeverisje lokale përkatësisht neni 68 i tij përcakton se komuna mbanë dy takime publike njeri në 6 mujorin e parë a ka mbajtur komuna juaj këtë takim publik në 6 mujorin e parë ju lutem të ceket data e takimit.

- Po, takimin e parë publik, e ka mbajtur me dt. 20.06.2024, ora 12:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.
- Po, takimin e dytë publik, e ka mbajtur me dt. 27.12.2024, ora 12:00, në sallën e Kuvendit të Komunës.

13. Komunitat janë të obliguara të mbajnë edhe takime publike për miratimin e rregulloreve apo buxhetet komunale a ka mbajtur komuna juaj takime të tilla nëse po sa takime ka mbajtur dhe për çfarë raste?

- 05 Prill 2024 - Diskutimi Publik për Draft - Strategjinë Komunale kundër dhunës në Familje 2024-2027 dhe plani i veprimit.
- 14 Maj 2024 – Diskutimi Publik për Draft-Planin Lokal të Veprimit në Mjedis.
- 12 Qershor 2024 - Diskutim publik për KAB.
- 15 Tetor 2024 - Diskutimi Publik për Draft - Planin e Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026.
- 18 Nëntor 2024 - Konsultimi Publik i K.K. Pejë për Draft-Planin e Punës së Kuvendit Komunal për vitin 2025.
- 20 Nëntor 2024 - Konsultimin Publik mbi Draft - Planin Lokal të Veprimit për Barazinë Gjinore 2024-2027.

14. Sa mbledhje ka mbajtur KKSBB për periudhën Janar-Dhjetor 2024?

- 6 (gjashtë) takime:
 1. me dt. 29.02.2024, ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës;
 2. me dt. 22.05.2024, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës;
 3. me dt. 20.06.2024, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës;

4. me dt. 19.09.2024, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës;
5. me dt. 23.10.2024, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës;
6. me dt. 16.12.2024, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës;

15. Ju lutem ti cekni temat që janë diskutuar në mbledhjet e KKSB.

- **Takimi parë, me dt. 29.02.2024, ora 11:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës**
- Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka raportuar për gjendjen aktuale në Komunë. Këtë vit e kemi filluar me disa projekte, të cilat kanë mbet pa u përfunduar nga viti i kaluar, pra këtë vit me plan të punës dhe plan të prokurimit e kemi rregullimin e sheshit, rregullimin e kanalizimeve të dyqaneve në shesh, vendosjen e rrymës nëntoksore në shesh, gjelbërimi ka me qenë i rikuperushëm dhe në funksion të qytetarëve, ndërtimin e urave njëra, e cila e lidh Puhovcin me Kapeshnicën, ndërsa ura tjetër fillon nga Kombinati i Lëkurkëpucëve, e cila e lidh pjesën me restorant "Universin" edhe del poshtë në rrugën për Prishtinë, vazhdimi i shëtitores, grantin e performancës, të cilin e kemi fitu është 1 milion e 752 mijë, janë 22 projekte të shpërndara nëpër fshatra dhe qytet, në pjesë të ndryshme për rregullim urban, punimi i ambulantës së re në fshatin Trestenik, do të përfundojë edhe shtegu i shëndetit hapësira tek uji i zi, punimet te kanali te furra "Husaj" dhe në lagjen "Fidanishte", rregullimin komplet të lagjes "Fidanishte" me kubëzim dhe ndriçim edhe rregullimin e kanalit mbi shkollë, ndërsa 280 mijë euro i kemi ndarë për rregullim të kanalit në lagjen "2 Korriku", rruga "Maja e Zezë" - Vitomiricë është përfunduar, ka filluar ndërtimi i çerdhes te shkolla e mesme ekonomike "Ali Hadri", e cila do të jetë një çerdhe e madhe, që do të përfundojë në vitin 2025, janë 68 kilometra rrugë në fshatra, që bëhen, pastaj janë 7 kilometra rrugë në qytet edhe janë 36 kilometra rrugë në Rugovë.
- Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për gjendjen në shkolla, situatën e zhvillimit të procesit arsimor, sigurinë në shkolla, përdorimin e substancave narkotike dhe bartjen e mjeteve të rrezikshme.
- **Takimi i dytë, me dt. 22.05.2024, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës;**
- Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka raportuar për gjendjen aktuale në Komunë.
- Raportin për gjendjen e sigurisë në Komunën e Pejës e prezantoi Komandanti i Policisë z.Idriz Atashi.
- Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për gjendjen në shkolla, situatën e zhvillimit të procesit arsimor dhe sigurinë në shkolla.

- Drejtoria e Inspekcionit prezantuan gjendjen e Shitje/Blerjes se ushqimit të përditshëm, prodhimi i pakontrolluar, datat e skaduara të prodhimeve dhe aktivitetin e tyre për parandalim dhe kontrollim.
- Aktivitetet për pengimin e krijimit të deponive ilegale te mbeturinave, prezantoj Drejtoresha e Inspekcionit, znj. Edonjeta Berisha.
- Agim Mala-udhëheqës i shërbimit social pranë QPS-së në Pejë, foli për dhunën në familje dhe mbrojtja e të drejtave të personave të cilët privohen nga të drejtat themelore.
- Nora Draga përfaqësuese e KLSP-së, foli për Identifikimin e brengave dhe shqetësimeve të qytetarëve lidhur me sigurinë publike.
- **Takimi i tretë, me dt. 20.06.2024, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës;**
- Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri i përshëndeti të pranishmit, të cilët i njoftoi s'e me projektin e grantit të performancës, me DEMOS-in dhe Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal janë 22 projekte dhe jemi orientuar kryesisht në trotuare dhe ndriçim publik për ta rritur sigurinë e qytetarëve, jemi të orientuar në fshatrat, të cilat lidhen me qytetin Loxha, Novosella, Vitomirica, Llozhani, pastaj te Sharra me kriju një bazen tjetër pak më të madh, për rekreacion dhe freskim, rregullimi i kanalit të Çokolicës, ndërsa për qentë endacak e kemi zhvilluar procedurën, objekti ka avancu mjaft, ku do të trajtohen qentë, po ashtu është duke vazhduar impianti për trajtimin e mbeturinave në Sverkë, ujësjellësi i Lugut të Baranit do të lidhet te rrethi në Vitomiricë, ku do të bëhet lidhja kryesore edhe një tjetër është në rrugë të Zahaqit, ndërsa sa i përket rrugës së Rugovës ajo është në domenin e Ministrisë së Infrastrukturës, po ashtu theksoi s'e e kemi sfidë të madhe dëmtimin e rrugëve, që është duke u bërë nga "Hidrodrini" për t'i kryer punët dhe shpresojmë, që këtë javë do t'i përfundojnë punimet, sepse po ka ngecje në trafik.
- Komandanti i Stacionit të Policisë në Pejë, z.Idriz Atashi ka raportuar për gjendjen e sigurisë në territorin e Komunës së Pejës.
- Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për situatën e zhvillimit të procesit arsimor, si dhe përgatitjet për procesin e përmbylljes së vitit shkollor 2023/2024.
- Lidhur me punën e Këshillave Lokal të Sigurisë Publike në territorin e Komunës së Pejës kanë raportuar znj.Nora Draga dhe z.Ranko Bakić.
- **Takimi i katërt, dt. 19.09.2024, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.**
- Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka raportuar për gjendjen aktuale në Komunën e Pejës, investimet, të cilat janë duke u kryer, rreth projekteve, rrugëve, të cilat i ka përfunduar Komuna e Pejës deri më tani.
- Komandanti i Stacionit të Policisë në Pejë, z.Idriz Atashi ka raportuar për gjendjen e sigurisë në territorin e Komunës së Pejës.

- Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për fillimin e procesit të të mësuarit, me theks të veçantë përgatitjet e fillimit të vitit shkollor 2024/2025.
 - Drejtori i Emergjencave në Komunën e Pejës, z.Gëzim Gashi ka raportuar për masat parandaluese dhe sensibilizimin e qytetarëve për pasojat nga zjarri gjatë periudhës së korrije-shirjeve dhe djegieve të pyjeve.
- Takimi i pestë, dt. 23.10.2024, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.**
- Kryetari i Komunës së Pejës, z.Gazmend Muhaxheri ka raportuar për gjendjen aktuale në Komunën e Pejës. Janë 23 procedura të prokurimit, që i kemi dhe disa projekte të ndryshme me grantin e performancës, ku 12-të prej tyre janë me Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal dhe 11-të të tjera janë në bashkëpunim me DEMOS-in, prej të gjithave 21 janë duke u zhvillu.
 - Drejtori për Arsim në Komunën e Pejës, z.Naser Gega ka raportuar për sigurinë në shkolla, përdorimin e substancave narkotike, bartjen e mjeteve të rrezikshme, angazhimet në parandalimin e sjelljeve devijuese dhe dhunës në shkollat e Komunës së Pejës me theks të veçantë në shkollat e mesme, si dhe transportin e nxënësve në viset rurale.
 - Drejtoresha e Inspekcionit në Komunën e Pejës, znj.Edonjeta Berisha ka raportuar për mbikëqyrjen e vazhdueshme të lokaleve dhe të kafiterive, veçanërisht ato, që ekzistojnë afër objekteve shkollore, ku mundësitë për trafikim me substanca narkotike janë më të mëdha.
 - Administrata e Përgjithshme - Sektori për Teknologji Informative - Udhëheqësi i Sektorit, z.Labinot Dezdari ka raportuar për progresin dhe ecurinë e aktivitetit të prokurimit për kamerat e qytetit dhe të ngjashme në fushën e kamerave të sigurisë, përfshirë sigurimin fizik të objekteve shkollore, objekteve të komunës, si dhe objekteve rekreative, kulturore, sportive etj.
 - Ndërsa për promovimin e vlerave të multietnicitetit dhe bashkëjetesës në vendbanimet ku jetojnë komunitetet e përziera kanë folur përfaqësuesit e komuniteteve.
 - Përfaqësuesi i komunitetit serb në Breštovik, z.Miodrag Dasic, përfaqësuesja e komunitetit serb në Gorazhdec, znj.Maja Sribljak, përfaqësuesja e komunitetit boshnjak, znj.Mersiha Adrovic, përfaqësuesja e komunitetit egjiptian, znj.Diana Sefaj, përfaqësuesja e komunitetit rom, znj.Hatixhe Muça, përfaqësuesja e shoqërisë civile, znj.Ardita Bala dhe përfaqësuesja e Komunitetit për Komunitete, znj.Fatlinda Radi.
- Takimi i gjashtë, dt. 16.12.2024, ora 10:00, në sallën e Kuvendit të Komunës së Pejës.**
- z.Gazmend Muhaxheri ka mbajtur takimin e gjashtë dhe të fundit për këtë vit.
 - Takimin e hapi Koordinatori i KKS-së, z.Fatmir Asllani, i cili pasi e konfirmoi pjesëmarrjen e prezantoi rendin e ditës, i cili u aprovua nga anëtarët e rregullt.
 - Fjalë hyrëse e mori kryetar i komunës z. Gazmend Muhaxheri, i cili prezantoi gjendjen aktuale në territorin e Komunës së Pejës.

- Komandant i Stacionit të Policisë në Pejë z. Idriz Atashi, prezantoi vlerësimin mbi çështjen e sigurisë në territorin e Komunës së Pejës.
- Nga Zyra Komunale për Komunitete dhe Kthim znj. Anela Hukiq, prezantoi informatën për procedurat e riintegrit të personave të riatdhesuar.
- Nga Drejtoria e Mirëqenies Sociale, për mbrojtjen e qytetarëve në nevojë për shërbimet sociale dhe familjare si dhe mbrojtja dhe ofrimi i shërbimeve për viktimat e dhunës në familje deri në riintegrim të viktimës foli Durim Kelmendi.
- Nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, drejtori Agron Nikqi, prezantoi gjendjen në terren, mirëmbajtjen e rrugëve dhe trotuareve për sezonin e dimrit, ndriçimi publik dhe tema të tjera për Infrastrukturën.
- Nga Drejtoria e Inspektionit, drejtoresha Edonjeta Berisha tregoi për marrjen e masave parandaluese për mënyrën e përdorimit të mjeteve piroteknike gjatë festave të fund vitit.

Udhëheqës i Sektorit
z. Avni GASHI




KRYESUESI I KUVENDIT,
z. Rexhep KURTBOGAJ

Shtojcë: Lista e akteve të miratuara nga Kuvendi i Komunës së Pejës për periudhën raportuese.

Nr.	Emri i aktit	Nr. Protokolit	Data e miratimit
1.	Vendimi Nr. 01-2024 mbi ndarjen - rezervimin e postit të ZV-Kryesuesit të Kuvendit të Komunës së Pejës	01-060/01-0008642	26.01.2024
2.	Vendim Nr. 02-2024 Mbi formimin e komisionit të zgjedhjes së drejtorit dhe zv-drejtorit të institucionit	0400/01-7582	26.01.2024
3.	Vendimi Nr. 03-2024 mbi për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit “Lumbardhë”	400-01/11637	27.02.2024
4.	Vendim Nr. 04-2024 - Mbi Autorizimin e DKRS-te për publikimin e Konkursit publik për tituj të nderit , dekorata, medalje, mirënjohje dhe falenderime	01-016/01-0013986	27.02.2024
5.	Vendimet Nr. 05-2024 - Mbi formimin e Komisionit të veçantë për tituj të nderit , dekorata, medalje, mirënjohje dhe falenderime.	01-016/01-0013982	27.02.2024
6.	Vendimi Nr. 06-2024 Mbi dhenjën në Diskutim PUBLIK Draft - Strategjia Komunale kundër dhunës në Familje 2024-2027 në Komunën e Pejës.	400-01/13479	27.02.2024
7.	Vendimi Nr. 07-2024 për rialokim dhe transferin e mjeteve buxhetore	400-01/27657	16.04.2024 Seanca e Jashtëzakonshme e K.K. Pejës
8.	Vendimi Nr. 08-2024 Mbi dhenjën në Diskutim PUBLIK Draft - Plan i Lokal i Veprimit në Mjedis 2024-2028	400-01/26859	26.04.2024
9.	Vendimi Nr. 09-2024 Mbi tejkalimin e planit të hyrave vetanake për vitin 2023 dhe bartjen në vitin 2024	400-01/29040	26.04.2024
10.	Vendimi Nr. 10-2024 Për bartjen e mjeteve të pa shpenzuara buxhetore nga viti 2023, në vitin 2024	400-01/29221	26.04.2024
11.	Vendimi Nr. 11-2024 për buxhetimin e bashkëfinancimit Komuna e Pejës - participimi nga qytetaret (fermeret përfitues)	400/01-29761	26.04.2024

12.	Vendim Nr. 12-2024 Nisma e bashkëpunim Komunal Nërkombëtar mes Komunës së Pejës dhe Komunës së Ulqinit, Rep. e Malit të Zi.	400-01/35429	28.05.2024
13.	Vendim Nr. 13-2024 për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Arton Kelmendi	463/01-36011	28.05.2024
14.	Vendim Nr. 14-2024 Mbi Shfuqizimin e Vendimit Nr. 03-2024 me nr.protokolli 400-0111637, të datës 27.02.2024 të Kuvendit të Komunës së Pejës	463-01/36017	28.05.2024
15.	Vendim Nr. 15-2024 mbi këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Avdyl Çetaj me qëllim të realizimit të shtegut të ecjes buzë Lumit''Lumbardhë''dhe ndërtimit ..	463-01/36013	28.05.2024
16.	Vendim Nr. 16-2024 për miratimin paraprak të vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës	463-01/36014	28.05.2024
17.	Vendim Nr. 17-2024 mbi formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në objekt të Komunës - dy(sportelevë) për aktivitete bankare.	463-01/36016	28.05.2024
18.	Vendim Nr. 18-2024 mbi formimin e komisionit të ankesave të palëve në procedurën e dhënies në shfrytëzim afat shkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme komunale	463-01/36018	28.05.2024
19.	Vendim Nr. 19-2024 -Plani Lokal i Veprimit në Mjedis Pejë 2024-2028	400-01/26859	28.05.2024
20.	Vendimi Nr.20-2024 mbi iniciativen e themelimit të inkubatorit të biznesit në Pejë	400-01/37458	28.05.2024
21.	Vendimi Nr.21-2024 për mbështetje financiare të Shoqatës së Zejtarëve, Hotelierëve dhe Afaristëve (SHZHA) me seli në Pejë me seli në Pejë	400-01/37995	28.05.2024

22.	Vendim Nr. 22-2024 Titulli Qytetar Nderi - Muhamed Kërveshi	05-400/01-27944	28.05.2024
23.	Vendim Nr. 23-2024 Titulli Qytetar Nderi - Donato Giuliani	05-400/01-27939	28.05.2024
24.	Vendim Nr. 24-2024 Titulli Nderi i Qytetit - Ramadan Krasniqi – Dani	05-400/01-27947	28.05.2024
25.	Vendim Nr. 25-2024 Titulli - Laureate për të Drejtat e Femrës - Drita Krasniqi	05-400/01-28956	28.05.2024
26.	Vendim Nr. 26-2024 Titulli - Laureate për të Drejtat e Femrës - Amb. Gjeneza Budima	05-400/01-35147	28.05.2024
27.	Vendim Nr. 27-2024 Titulli - Laureate për të Drejtat e Femrës - Amb. Lendita Haxhitasim	05-400/01-35147	28.05.2024
28.	Vendim Nr. 28-2024 Titulli - Laureate për të Drejtat e Femrës - Amb. Nita Luci	05-400/01-35147	28.05.2024
29.	Vendim Nr. 29-2024 Titulli Qytetar Nderi - Post Mortum Prof. Halil Agusholli	05-400/01-30112	28.05.2024
30.	Vendim Nr. 30-2024 Titulli Qytetar Nderi - Post Mortum Prof. Sadri Kelmendi	05-400/01-28941	28.05.2024
31.	Vendim Nr. 31-2024 Titulli Qytetar Nderi - Post Mortum - Vajdin Xhafa	05-400/01-27558	28.05.2024
32.	Vendim Nr. 32-2024 Titulli Qytetar Nderi - Post Mortum - Haki Begolli	05-016/01-26864	28.05.2024
33.	Vendim Nr. 33-2024 Titulli Qytetar Nderi - Post Mortum - Fetah Musa	05-400/01-27953	28.05.2024
34.	Vendim Nr. 34-2024 Titulli Qytetar Nderi - Post Mortum - Hamdi Qavolli	05-400/01-28437	28.05.2024
35.	Vendim Nr. 35-2024 Titulli Mirënjohje - Kolonel Francesco Ferrara	05-400/01-37701	28.05.2024
36.	Vendim Nr. 36-2024 Titulli Mirënjohje - Major Pietro Caprio	05-400/01-37701	28.05.2024
37.	Vendim Nr. 37-2024 Titulli Mirënjohje - Lejtnant Kolonel Giuseppe Acone	05-400/01-37701	28.05.2024

38.	Vendim Nr. 38-2024 Titulli Mirënjohje - Emrush Çeku	05-400/01-37701	28.05.2024
39.	Vendim Nr. 39-2024 Titulli Mirënjohje - Brahim Ibër Krasniqi	05-400/01-28599	28.05.2024
40.	Vendim Nr. 40-2024 Titulli Mirënjohje - Post Mortum Azem (Rexha) Mulaj	05-400/01-28633	28.05.2024
41.	Vendim Nr. 41-2024 Titulli Mirënjohje - Post Mortum Arben (Sylë) Kadriu	05-400/01-28220	28.05.2024
42.	Vendim Nr. 42-2024 Titulli Mirënjohje - Nënkolonel Veton Elshani	05-400/01-25529	28.05.2024
43.	Vendim Nr. 43-2024 - Mbi miratimin e KAB-it - 2025 - 2027	400-01/45794	28.06.2024
44.	Vendim Nr. 44-2024 mbi shfuqizimin e Vendimit Nr. 22-219 të K.K. Pejë	463-01/46363	28.06.2024
45.	Vendimi Nr. 45-2024 për buxhetimin e bashkëfinancimit Komuna e Pejës - participimi nga qytetaret (fermeret përfitues)	400-01/53073	26.07.2024
46.	Vendim Nr. 46-2024 mbi raportin e vlerësimit të dëmëve të shkaktuara, korrik 2023 - korrik 2024	400/01-54204	26.07.2024
47.	Vendimi Nr. 47-2024 mbi formimin e Komisioni për hartimi e Planit të punës së K.K. për vitin 2025.	016/01-54848	26.07.2024
48.	Vendim Nr. 48-2024 - Strategjia Komunale kundër dhunës në Familje 2024-2027 dhe plani i veprimit	400-01/13479	26.07.2024
	Konkluzion nga Seanca e Jashtëzakonshme e K.K. Pejë, dt. 13.09.2024	0400-01/74076	13.09.2024 Seancë e Jashtëzakonshme
49.	Vendim Nr. 49-2024 mbi miratimi i Planit të Buxhetit të Komunës së Pejës 2025 - 2027	400-01/70644	27.09.2024

50.	Vendim Nr. 50-2024 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Fatmir Zymberi	463/01-74093	27.09.2024
51.	Vendim Nr. 51-2024 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj Ajmon Sefa	463/01-74089	27.09.2024
52.	Vendim Nr. 52-2024 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z Sali (Shaban) Qelaj	463/01-74082	27.09.2024
53.	Vendim Nr. 53-2024 mbi Kompenzim të kryetarëve të Këshillave Lokale	400-01/74419	27.09.2024
54.	Vendim Nr. 54-2024 mbi Kompenzim e Komiteteve Konsultative dhe Komiteteve Tjera	400-01/76384	27.09.2024
55.	Vendim Nr. 55-2024 mbi Kompenzim e anëtareve të KKSB	400/01-74427	27.09.2024
56.	Vendimi Nr. 56-2024 Mbi dhënie në diskutim publik të Draft –Planit të Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026	400-01/76387	27.09.2024
57.	Vendimi Nr. 57-2024 Mbi dhënie në diskutim publik të Draft Rregullores për Sherbimin e Transportit me Marimangë në territorin e Komunës së Pejës	400-01/74424	27.09.2024

58.	Vendimi Nr. 58-2024 Mbi caktimin e normave tatimore për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2025	400-01/83742	29.10.2024
59.	Vendimi Nr. 59-2024 për faljen e borxhëve në taksa afariste për bizneset që kanë operuar dhe operojnë në Komunën e Pejës	400-01/83731	29.10.2024
60.	Vendim Nr. 60-2024 - Plani i Veprimit kundër braktisjes dhe mosregjistrimit të shkollës, 2024-2026	400-01/76387	29.10.2024
61.	Vendim Nr. 61-2024 mbi miratimin e listës së veçantë të pronave Komunale të Komunës së Pejës që do të jepen në shfrytëzim gjatë vitit 2025	400/01-87552	29.10.2024
62.	Vendim Nr. 62-2024 mbi shpalljen e interesit publik për krijimin e hapësirës për varreza në fsh. Ramun.	400/01-86625	29.10.2024
63.	Vendim Nr. 63 - 2024 mbi miratimin e Planit të Punës së K.K. Pejës për vitin 2025	060/01-90383	29.11.2024
64.	Vendim Nr. 64- 2024 mbi miratimin e Klandearit të takimeve të KPF dhe K.K. Pejës për vitin 2025	060/01-93227	29.11.2024
65.	Vendim Nr. 65-2024 - Plani Lokal i Veprimit për Barazinë Gjinore, 2024 – 2027	016/01-90609	29.11.2024
66.	Vendimi Nr 66-2024 për transferin e mjeteve buxhetore	400-01/93406	29.11.2024
67.	Vendim Nr.67-2024 mbi zëvendësimin	060/01-101246	30.12.2024

	e anëtarit të KPF-së		
68.	Vendim Nr. 68-2024 mbi miratimin e Planit të Punës së KKSBB-së	400/01-97500	30.12.2024
69.	Vendim Nr. 69-2024 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të Bashkim Tatars - Komuna Pejë	400/01-97931	30.12.2024
70.	Vendim Nr. 70-2024 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të znj. Ryve Muqolli - Komuna Pejë.	400/01-97930	30.12.2024
71.	Vendim Nr. 71-2024 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën private të z. Valon Kalijani - Komuna Pejë	400/01-97928	30.12.2024
72.	Vendim Nr. 72-2024 mbi miratimin e propozimit të Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme Komunale me pronën e pronarëve privat - Komuna Pejë	400/01-97925	30.12.2024
73.	Vendim Nr. 73-2024 për miratimin paraprak të vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fsh. Lutogllavë për Deponi Druri	463/01-98156	30.12.2024
74.	Vendim Nr. 74-2024 për miratimin paraprak të vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fsh.	463/01-98153	30.12.2024

	Lutogllavë për Deponi - Gomë		
75.	Vendim Nr. 75-2024 për miratimin paraprak të vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fsh. Lutogllavë për Deponi - material i fortë	463/01-98150	30.12.2024
76.	Vendim Nr. 76-2024 për miratimin paraprak të vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në zyret e ish QPS	463/01-98164	30.12.2024
77.	Vendim Nr. 77-2024 për miratimin paraprak të vendimit për dhënie në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në zyret e katit III të Poliklinika Stomatologjike	463/01-98159	30.12.2024
78.	Vendim Nr. 78-2024 mbi formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fsh. Lutogllavë për Deponi Druri.	463/01-98093	30.12.2024
79.	Vendim Nr. 79-2024 mbi formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fsh. Lutogllav - Gomë	463/01-98101	30.12.2024
80.	Vendim Nr. 80-2024 mbi formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në fsh. Lutogllav -material i fortë	463/01-98103	30.12.2024

81.	Vendim Nr. 81-2024 mbi formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në ish zyret e QPS-së	463/01-98144	30.12.2024
82.	Vendim Nr. 82-2024 mbi formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim afat shkurtër të pronës së paluajtshme Komunale në Pol. Stomatologjike	463/01-98126	30.12.2024
83.	Vendimi Nr. 83-2024 për korrigjim të transferit të kategorive ekonomike në kategorinë paga dhe shtesa.	016/01-101762	30.12.2024



Formulari per kerkese apo ankese

Drejtatori/Njesia
Kuvendi Komunal

Data 06/01/2025

1. Informatat personale te parashtruesit te kerkeses:

Emri dhe mbiemri

KUVENDI KOMUNAL -PEJE

Numri personal

600346466

Adresa e vendbanimit

Peje

E-mail Adresa

Numri i tel. fiks

Numri i tel. mobil

40000000

2. Mënyra e pranimit

Raport

Statusi i lëndës

Ne proces

Vlera për pagesë: 0.00

Mos shkruani në këtë pjesë

Numri i protokolit

01-016/01-0000789/25

Afati i zgjedhjes

05/02/2025

Vendimi

3. Ju lutemi të shkruani kërkesën apo ankesën tuaj në detaje:

Raport i funksionimit te kuvendeve te komunave per periudhen Janar Dhejtor 2024

4. Dokumentet e bashkangjitura:

Nr. Lloji i dokumentit

1 789_202501061419
06.pdf

5. Dëshmia e aplikuesit për vërtetësi

Unë KUVENDI KOMUNAL -PEJE vërtetoj se informatat e lartshënuara janë të vërteta.

(Nënshkrimi)

*Ju lutemi të kërkonti nga zyrtari/ja fletëdëshminë për dorëzimin e kësaj kërkesë dhe dokumenteve të bashkangjitura

Pranuar nga: besnike.bytyqi